



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Komisioni i Apelit

Nr. 32 Prot

Shkodër, më 13.07.2024

VENDIM

Nr. 10

Datë: 13.07.2024

Komisioni i Apelit, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2024, bazuar në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në U.SH", neni 36, pika 1 dhe 6, neni 38, pika 1, si dhe në nenin 1 të Rregullores së Komisionit të Apelit, shqyrtoi ankimimin e Z. Ildir Duhaxhi me nr. prot. 30, i datës 13.07.2024 me lëndë shpalljen e pavlefshme të vendimit nr. 38, datë 10.07.2024 të KIZ-it.

K.A arsyeton se : Me vendimin nr. 27 të KIZ-it, me nr. prot 226, i datës 26.06.2024, bëhet shpallja e rezultateve të zgjedhjeve për anëtar të Senatit Akademik në cdo fakultet, ndërsa me vendimin nr. 30 i KIZ, me nr. prot. 229, i datës 29.06.2024, bëhet shpallja e hapjes së raundit të dytë për anëtar të Senatit Akademik për vendin vakant në Fakultetin e Drejtësisë dhe vendosjen e afateve për dorëzim dokumentacioni nga cdo person i interesuar për kandidim apo ri-kandidim (nga data 1.07.2023 deri në datën 3.07.2024), me vendimin nr. 31 të KIZ me nr. prot. 234 i datës 02.07.2024, bëhet ndryshimi i datës së zgjedhjeve të raundit të dytë dhe zgjatja e afatit për dorëzim dokumentacioni nga cdo kandidat (afati i dorëzimit të dokumentacionit për kandidim 01.07.2024-05.07.2024). Z. Ildir Duhaxhi, nuk ka sjell ankimi pranë KA-së për këto dy vendime ku qartazi kuptohet që ai është kandidati humbës i raundit të parë (bauzar dhe tek vendimi nr. 20 i KIZ-it, me datë 17.06.2024, tek shënimi i vendosur në cdo fletë votimi mbi kandidatët fitues dhe renditjen e kandidatëve fitues) dhe as nuk ka dorëzuar dokumentacion për ri-kandidim në Senatin Akademik, në raundin e dytë. Sipas nenit 36, pika 1 dhe nenit 38, pika 1, të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në U.SH", cdo ankim për pavlefshmëri, për një raund të dytë të zgjedhjeve për vendin bosh në Senatin Akademik, bëhet nga kandidatët pjesëmarrës kur çënohen interesat e tij. Në këtë rast Z. Ildir Duhaxhi, nuk ka qënë kandidat i raundit të dytë dhe nuk janë çënuar interesat e tij të drejtpërdrejta. Z. Ildir Duhaxhi, gjithashtu, nuk ka dorëzuar dokumentacion për të ri-kandiduar pas shpalljes së rezultatit të raundit të parë, me 20 vota kundër dhe një votë pro, që të legjitimohet interesi i tij

i drejtpërdrejte në zhvillimet e raundit të dytë dhe në ankimim mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë raund, sipas argumentave të parashtruar. Me unanimitet K.A,

VENDOS:

1. Mospranimin e ankimimit të Z. Ildir Duhaxhi, duke qënë se subjekti nuk legjitimohet si ankues.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ky vendim publikohet në mjediset zyrtare publike të K.A në faqen zyrtare të U.SH.

Kryetare

Arselida Mashaj



Sekretare

Ambra Kokaj



Anëtar

Hajrije Dibra



Sereta Koperaj



Arjeta Anamali

